

VENDIM
Nr.147, datë 21.3.2007

PËR CILËSINË E LËNDËVE DJEGËSE, BENZINË DHE DIEZEL

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5 të nenit 10 të ligjit nr. 8897 , datë 16.5.2002 "Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja", me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në territorin e Republikës së Shqipërisë lejohet vetëm tregtimi i benzinës pa plumb, që, në nomenklaturën e mallrave, përshkruhet në kadet CN 27101141, 27101145, 27101149, 27101151 dhe 27101159 dhe që plotëson kërkesat e përcaktuara në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Në territorin e Republikës së Shqipërisë, duke filluar nga data 1 janar 2009, do të lejohet, për përdorim në automjetet rrugore dhe gjeneratorët, vetëm tregtimi i lëndës djegëse diezel, që, në nomenklaturën e mallrave, përshkruhet në kodin 27101941, që plotëson kërkesat e standardit shqiptar S SH EN 590 ose të standardeve të tjera, të barasvlershme me të, me përjashtim të kushtit për përmbajtjen e sqfurit, siç parashikohet në aneksin 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 3. Nga data 1 janar 2009, përmbajtja e sqfurit në lëndën djegëse, për motorët diezel, nuk lejohet të kalojë 350 mg/kg.
 4. Nga data 1 janar 2011, përmbajtja e sqfurit në lëndën djegëse, për motorët diezel, nuk lejohet të kalojë 10 mg/kg.
 5. Duke filluar nga data 1 janar 2009, të gjitha pikat e shitjes duhet të reklamojnë, qartë dhe dukshëm, për blerësit:
 - a) përputhjen e parametrave mjedisorë të benzinës me standardin shqiptar S SH EN 228, në fuqi, ose me standardet e tjera, të barasvlershme me të;
 - b) përmbajtjen maksimale, të lejueshme të sqfurit, si dhe përputhjen e parametrave mjedisorë të diezELIT me standardin shqiptar S SH EN 590 ose standardet e tjera, të barasvlershme me të.
 6. Testimi i çdo parametri të bëhet sipas metodave të testimit, si më poshtë vijon:
 - a) Për benzinën-sipas standardit shqiptar S SH EN 228 ose standardeve të tjera, të barasvlershme me të;
 - b) Për diezELIN-sipas standardit shqiptar S SH EN 590 ose standardeve të tjera të barasvlershme me të.
 7. Ngarkohen Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës të miratojnë udhëzimin e përbashkët për mbledhjen dhe ruajtjen e të dhënave, për cilësinë e benzinës dhe të diezELIT.
 8. Nëse pas datës 1 janar 2009 evidentohen subjekte, që tregtojnë lëndë djegëse, me cilësi, që nuk respekton kërkesat e këtij vendimi, lënda djegëse sekuestrohet. Inspektorati Qendror Teknik përcakton destinacionin e lëndës djegëse të sekuestruar.
 9. Ngarkohet Inspektorati Qendror Teknik për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi dhe të udhëzimit të përcaktuar në pikën 7.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Aneksi 1**Parametrat e lejuar mjedisorë për cilësinë e lëndës diegëse benzinë**

Parametrat	Njesia	Limitet	
		Minimum	Maksimum
Numri i kerkuar i oktanit		95	—
Numri i oktanit per motorrin		85	—
Presioni i avullit ne periudhen e veres	kPa	—	60,0
Distilimi:			
— perqindja e avulluar ne 100 °C	% v/v	46,0	—
— perqindja e avulluar ne 150 °C	% v/v	75,0	—
Analiza e hidrokarbureve:			
— olefinat	% v/v	—	18,0
— aromatiket	% v/v	—	35,0
— benzene	% v/v	—	1,0
Permbajtja e oksigjenit	% m/m	—	2,7
Oksigjenate			
— metanol (agjente stabilizues qe duhen situar	% v/v	—	3
— etanol (agjente stabilizues mund te jene te nevojshem)	% v/v	—	5
— alko-ol iso-propyl	% v/v	—	10
— alko-ol teri-butyl	% v/v	—	7
— alko-ol iso-butyl	% v/v	—	10
— etere me permbajtje karboni 5 ose me shume	% v/v	—	15
— Oksigjenate te tjera ⁽¹⁾	% v/v	—	10
Permbajtja e sqfurit	mg/kg	—	50 (deri ne 31 Dhjetor 2008)
	mg/kg	—	10 (1 Janar 2009)
Permbajtja e plumbit	g/l	—	0,005

1. ⁽¹⁾ mono-alkohole te tjera me pike vlimi finale jo me te larte se ato te percaktuara ne Standartin Shqiptar S SH EN 228, ne fuqi ose standarte te tjera te barazvlefshme me te

Aneksi 2
Parametrat e lejuar mjedisorë për cilësinë e lëndës djegëse diesel

Parametrat	Njësia	Limitet	
		Minimum	Maksimum
Numri i cetanit		51.0	
Densiteti në 15oc	Kg/m ³	“	845
Pika e distilimit 95%	C	“	360
Hidrokarbure policiklike aromatike	%m/m	“	11
Përmbajtja e squfurit	mg/kg	“	350 nga 01.01.2009 - 31.12.2010; 10 nga 01.01.2011
Mbeturina karboni (mbi 10% mbeturina distilimi)	% (m/m)	“	0.30
Përmbajtje hiri	% (m/m)	“	0.01
Ndotja totale	mg/kg	“	24

Tabella e Përputhshmërisë (2)

si Projektvendimi për "Klasime e lëndëve djegëse benzine dhe dizel" me Direktivën 98/70/EC të Parlamentit Europian dhe të Këshillit të datës 13 Tetor 1998, në lidhje me klasime e lëndëve djegëse benzine dhe dizel që amendojnë Direktivën e Këshillit 93/12/EEC (CJ 330, 28.12.1998, p.58) e amenduar nga Direktiva e Komisionit 2000/71/EC e 7 Nëntori 2000 (L287, p.46, datë 14.11.2000); Direktiva 2003/17/EC e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e 3 Marsit 2003, dhe Rregulloren (EC) nr.1882/2003 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e 29 Shtatorit 2003

a)	b)	c)	d)	e)
Niveli përputhës	Niveli përputhës	Niveli përputhës	Niveli përputhës	Niveli përputhës
<p>1. Në territorin e Republikës së Shqipërisë, duke filluar nga tregtimi i benzines pa plumb, që në nënmenklaturën e mallrave përshkruhet në kodet CN 27101141, 27101145, 27101149, 27101151 dhe 27101159 dhe që plotëson kërkesat e përcaktuara në Aneksin I, bashkëdhjetur këtu vendimi.</p>	<p>b) Neni 2/1 "benzine" nënkupton çdo vaj të avullueshëm të synuar për funksionimin e motorëve me djegie të brendshme me ndëzje me ngarkesë polare pozitive për shpërbërje të cilat bëjnë pjesë në kodet CN 27101141, 27101145, 2710 1149, 2710 1151 dhe 2710 1159 (2);</p> <p>Neni 3/1 Jo më vonë se data 1 janar 2000, Shtetet Anëtare do të ndalojnë tregtimin e benzines me plumb brenda territorit të tyre.</p> <p>Neni 3/2/e Jo më vonë se data 1 janar 2009, Shtetet Anëtare do të sigurojnë që benzina pa plumb të mund të tregtohet në territorin e tyre, vetëm nëse është në përputhje me specifikimin mjedisor të përcaktuar në Shojcën III, me përjashtim të përmbajtjes së shtuar që do të jetë maksimumi 10 mg/Kg.</p>	1 plote	--	--
<p>2. Në territorin e Republikës së Shqipërisë, duke filluar nga data 1 Janar 2009, për periodim në automjetet rruqore dhe gjeneratori, do të lejohet vetëm tregtimi i lëndës djegëse dizel, që në nënmenklaturën e mallrave përshkruhet në kodin 27101941, që plotëson kërkesat e Standardit Shqipëtar S SH EN 590 ose standarde të tjera të barazvlefshme me të, me përjashtim të kushtit të lidhur me përmbajtjen e shtuar, siç parashikohet në Aneksin 2, bashkëdhjetur këtu vendimi.</p>	<p>Neni 2/2 "lëndë djegëse dizel", nënkuptojnë produktet e naftës që bëjnë pjesë në kodin CN 2710 19 41 (2) dhe përdoren për automjetet vetëkryesë, siç referohen në Direktivën 70/ 220/EEC dhe Direktivën 88/77/EEC;</p> <p>Neni 4/1/e Jo më vonë se data 1 janar 2009, duke iu referuar dispozitave të Neni 9(1)(a), Shtetet Anëtare do të sigurojnë që lëndët djegëse të dizelit të mund të tregtohen në territorin e tyre, vetëm nëse janë në përputhje me specifikimet mjedisorë të përcaktuara në Shojcën IV, me përjashtim të përmbajtjes së shtuar që do të jetë maksimumi 10 mg/Kg.</p>	I pjesëskem	Ekonomik, financiare, sociale	Standardi, me përjashtim të përmbajtjes së shtuar, hyn nënkohësisht në vendet anëtare. Projekt-VKM parashikon një ulje gradualë të përmbajtjes së shtuar (jo në 1 Janar kërkesa e direktivës për përmbajtjen e shtuarit në mëse 10 mg/Kg do të plotësohet në 1 Janar 2011
<p>3. Nga data 1 Janar 2009, përmbajtja e shtuarit në lëndën djegëse për motorët dizel nuk lejohet të kalojë 350 mg/Kg.</p>		1 paktueshëm	--	--
<p>4. Nga data 1 Janar 2011 përmbajtja e shtuarit në lëndën djegëse për motorët dizel nuk lejohet të kalojë 10 mg/Kg.</p>	<p>Neni 4/1/e Jo më vonë se data 1 janar 2009, duke iu referuar dispozitave të Neni 9(1)(a), Shtetet Anëtare do të sigurojnë që lëndët djegëse përputhje me specifikimet mjedisorë të përcaktuara në Shojcën IV, me përjashtim të përmbajtjes së shtuarit që do të jetë</p>	1 plote	--	--

<p>3. Duke filluar nga 1 Janari 2009, të gjitha pikat e shitjes duhet të reklamohen qartë dhe dukshëm për blerësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> a. përputhjen e parametrave mjedisorë të benzines me standardin shqiptar S SH EN 228 në fuqi ose standarte të tjera të barazvlefshme me të. b. përmbajtjen maksimale të lejueshme të squfurit si dhe përputhjen e parametrave mjedisorë të diezellit me standardin shqiptar S SH EN 590 ose standarte të tjera të barazvlefshëm me të. 		I pazbatueshem	--	--
<p>6. Testimi i çdo parametri do të bëhet sipas metodave të testimit si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> a. për benzinen, sipas standardit shqiptar S SH EN 228, ose standarte të tjera të barazvlefshme me të. b. për diezelin, sipas standardit shqiptar S SH EN 590, ose standarte të tjera të barazvlefshme me të. 	<p>Neni 8/1</p> <p>Shiteti Anëtarë do të monitorojnë pajtueshmërinë me kërkesat e Neneve 3 dhe 4 në lidhje me benzinen dhe lëndët djegëse diesel, mbi bazën e metodave analitike të referuara përkatësisht në standardet Europiane EN 228:1999 dhe EN 590:1999.</p> <p>Neni 8/2</p> <p>Shiteti Anëtarë do të krijojnë sistemin e monitorimit të cilësive së lëndëve djegëse në përputhje me kërkesat e standardeve përkatëse Europiane. Përdorimi i sistemit të monitorimit të cilësive së lëndëve djegëse alternative mund të lejohet, me kusht që ky sistem të sigurojë rezultate ngjelloj të besueshme.</p>	I plotë	--	--
<p>7. Ngarkohen Ministri i Mjedisit, Pyeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministri i Ekonomisë, Tregut dhe Energjitikës të miratojnë udhëzimin e përshkaktet për mbledhjen dhe ruajtjen e të dhënave për cilësinë e benzines dhe diezelit.</p>	<p>Neni 8/3</p> <p>Çdo vit, deri më 30 qershor, Shiteti Anëtarë do të dorëzojnë një raport në lidhje me të dhënat në nivel kombëtar për cilësinë e lëndëve djegëse për vitin paraardhës kalendarak.</p>	I pjeshem	--	Udhëzimi i përshkaktet do të përgatitet dhe r miratimit të këtij projektvendimi.
<p>8. Nese pas 1 Janarit 2009, evidencohen subjekte që tregtojnë lëndë djegëse me cilësi që nuk respekton kërkesat e këtij Vendimi, lenda djegëse sekuestrohet.</p>		I pazbatueshem	--	--
<p>9. Ngarkohet Inspektorati Qendror Teknik për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi, të udhëzimit të parashkuar në pikën 7 dhe përcaktimin e destinacionit të lëndës djegëse të sekuestruar të parashkuar në pikën 8 të këtij vendimi.</p>		I pazbatueshem	--	--

Analiza I (benzina)

Parametri	Njësia	Limitet	
		Minimum	Maksimum
Numrit i kërkuar i oksantit		95	—
Numrit i oksantit per motorin		85	—
Presioni i avullit ne perudhat e veres	kPa	—	60,0
Distillimi:			
— perqindja e avulluar ne 100 °C	% v/v	46,0	—
— perqindja e avulluar ne 150 °C	% v/v	75,0	—
Analiza e hidrokarbureve:			
— olefinat	% v/v	—	18,0
— aromatiket	% v/v	—	35,0
— benzene	% v/v	—	1,0
Permbajtja e oksigjenit	%	—	2,7
Oksigjenat:			
— metanol (agjente stabilizues qe % v/v duken shuar)	qet % v/v	—	3
— etanol (agjente stabilizues mund te jete te nevojshem)	te % v/v	—	5
— alko-ol iso-propyl	% v/v	—	10
— alko-ol tert-butyl	% v/v	—	7
— alko-ol iso-butyl	% v/v	—	10
— etere ne permbajtje karboni ose ne shume	% v/v	—	15
— Oksigjenat e tjera (1)	% v/v	—	10
Permbajtja e squarut	mg/kg	—	50 (aktualisht)
	mg/kg	—	50 (detyr ne 31)
	mg/kg	—	10
Permbajtja e plumbit	g/l	—	0,005

Analiza III (benzina)

Parametri (1)	Njësia	Limitet	
		Minimumi	Maksimumi
Numrit i kërkuar te oksantit		95 (2)	—
Numrit i oksantit ne motor		85	—
Presioni i avullit perudhat e veres te veres shumet period (3)	kPa	—	60,0 (5)
Distillimi:			
— perqindja e avulluar ne 100 °C	% v/v	46,0	—
— perqindja e avulluar ne 150 °C	% v/v	75,0	—
Analize e hidrokarburi:			
— elemente te hidrokarbureve te pangopur	% v/v	—	18,0
— linder aromatike	% v/v	—	35,0
— benzoli	% v/v	—	1,0
Permbajtja e oksigjenit	% m/m	—	2,7
Oksidimet:			
— metanol (duhet te shohet agjendet stabilizues)	% v/v	—	3
— etanol (agjente stabilizues mund te jete te nevojshme)	% v/v	—	5
— alko-ol izopropilik	% v/v	—	10
— alko-ol tert-butilik	% v/v	—	7
— alko-ol izobutilik	% v/v	—	10
— etere dietilike qe permbajne 5 ose me shume atome karboni	% v/v	—	15
— Oksidimet te tjera (1)	% v/v	—	10
Permbajtja e squarut	mg/kg	—	50
	mg/kg	—	100 (7)
Permbajtja e plumbit	g/l	—	0,005

I plotë

Aneksi 2 (dizeli)

Parametri	Njesia	Limitet	
		Minimum	Maksimum
Numri i Cetanit		51.0	1
Densiteti ne 15°C	Kg/m ³	--	845
Pika e distilimit 95%	°C	--	360
Hidrokarbure polieklike aromatike	%m/m	--	11
Permbajtja e squfurit	mg/kg	--	350 nga 01.01.2009 – 31.12.2010; 10 nga 01.01.2011
Mbeturina karboni (mbi 10% mbeturina distilimi)	% (m/m)	--	0.30
Permbajtje hiri	% (m/m)	--	0.01
Ndojta totale	mg/kg	--	24

Aneksi IV (dizeli)

Parametri (1)	Nivësia	Limitet		I pleshëm	Ekonomik e, financiare, sociale	Standardi, me përjashtim të përmbajtjes së squfurit, hyn në fuqi njëkohësisht në vendet anëtare. Projekt-VKM parashikon një ulje graduale të përmbajtjes së squfurit (jo në 1 Janar 2009 sic kërkojnë direktivat). Kërkesa e direktives për përmbajtjen së squfurit në masën 10 mg/kg do përfundojë në 1 Janar 2011
		Minimumi	Maksimumi			
Nivëri i Cetanit		51.0	---			
Dendësia në 15 °C	kg/m ³	---	845			
Distillimi:						
— 95 % (v/v) përpunuar në	°C	---	360			
Hidrokarburet aromatike hidrocarbours	aromatike % m/m	---	11			
Përmbajtja e squfurit	mg/kg	---	50			
	mg/kg	---	10			